


## Recension

# MBI ANTROPOLOGJINË DHE ÇËSHTJET KULTURORE - NGA TEORIA NË PRAKTIKË

Arsim Canolli, “Antropologjia kulturore” – Hyrje e shkurtër, botoi: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, 2024, 210 faqe.



Libri universitar “Antropologjia kulturore – Hyrje e shkurtër” i autorit Arsim Canolli është kontributi i tij i radhës në fushën e antropologjisë. Edhe pse i kushtohet kryesisht studentëve të interesuar për këtë fushë, libri vjen si një informues dhe/apo përkujtues i mirë e i shpejtë xhepi që i shërben edhe studiuesve të fushave të ndryshme, por edhe vetë antropologëve. Libri fillon me

*Parathënien*, në të cilën autori tregon se ky libër është rezultat i ligjërimeve afër dhjetëvjeçare për lëndën “Antropologji sociale” në Departamentin e Sociologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Libri përbëhet nga 10 kapituj, të cilët ndahen në dy pjesë - 5 kapitujt e parë ofrojnë një njohje me antropologjinë, metodat, teoritë, qasjet, prijatarët, shkrimin dhe diskursin antropologjik në përgjithësi, duke filluar me titullin 1. *Çfarë është antropologjia?*, e për të vazhduar me 2. *Fillet e antropologjisë*, 3. *Natyra dhe kultura*, 4. *Metodat dhe teoritë në antropologji kulturore* dhe 5. *Shkrimi antropologjik*. Ndërsa 5 kapitujt e tjerë trajtojnë disa nga tematikat kryesore në antropologji kulturore, si: 6. *Familja dhe farefisnia*, 7. *Etnia, kombi dhe shteti*, 8. *Rituali dhe festa*, 9. *Tradita dhe*

*trashëgimia kulturore* dhe 10. *Identiteti social*. Përpos këtyre, pjesë të librit janë edhe shtojca me udhëzime për punën në terren, fjalorthi me shpjegime për disa nga termat më të rëndësishëm të fushën e antropologjisë, pastaj bibliografia, si dhe indeksi i emrave. Po t'i lejojmë vetes të shprehemi në mënyrë figurative, mund të themi se autori në këtë libër me shumë elokuencë, pa u ndalur menjëherë te drunjtë antropologjikë (qasjet, teoritë, rrymat) jep një pamje të “pyllit” antropologjik, pra shumësinë apo tërësinë e antropologjisë, duke e çuar si me dron lexuesin sa në fillet e antropologjisë nga kontinenti në kontinent dhe grupet shoqërore e kulturat e tyre të interesimit, sa në fenomenet më bashkëkohore shoqërore që po njihen si globale. Veçanti e këtij libri është po ashtu fakti se, derisa Canolli flet për historinë e antropologjisë kulturore, duke nisur që nga shkrimet parantropologjike të filozofëve për kutura të ndryshme e mëpastaj të udhëpërshkruesve, “turistëve” të parë aristokratë, misionarëve, diplomatëve etj., ai me shumë vëmendje e plotëson edhe me të dhënat për interesimet,

shkrimet e po të “njëjtave” struktura për popullin e kulturën shqiptare. Kjo paralele gjithsesi që e bën më të lehtë e më të kapshëm kontekstin e antropologjisë si shkencë, si studim, si njohje. Kështu, në kapitullin *Çfarë është antropologjia*, Canolli njofton lexuesin me konceptet bazë të kësaj disipline, si bie fjala çfarë janë shoqëria, kultura, botëkuptimi, struktura shoqërore, konteksti, diversiteti, si dhe dinamikat e interaksionit të këtyre që çojnë antropologët tek interpretimi mbi bartjen, shpërndarjen, ndikimet e ndryshimet e tyre, të përgjithshmet e të veçantat. Me sqarimin e këtyre nuancave ai bën të kuptohet se cili është synimi i këtyre studimeve, me cilat qasje janë studiuar fenomenet e ndryshme. Të gjitha këto plotësojnë kërshërinë dhe nxisin imagjinatën e mundësinë e rrëfimeve jetësore, individuale a kolektive, lokale a rajonale që vijnë edhe si përgjigje të pyetjes se *çfarë na duhet antropologjia*. Në kapitullin e dytë *Fillet e antropologjisë* flet se kur kishin filluar këto studime, cilët ishin antropologët e parë dhe cilat teori a metoda kishin rezultuar si rrjedhojë e tyre, çka e bën

antropologjinë unike dhe si kuptohen e dallohen antropologjia dhe etnologjia. Gjatë elaborimit mjaft të veçantë të çështjeve autori jep informata përtej atyre të mirëpranuara e të etabluara në teorinë e antropologjisë, si p.sh. e dhëna se për antropologjinë e katër fushave është menduar e kishte folur për dekada para Boasit, August Pit Rivers në Britani. Ai ngjashëm vepron në secilin kapitull, ku patjetër shtjellon shembuj konkretë si botërorë, ashtu edhe nga kultura shqiptare, qoftë kur flet për teoritë, qasjet, konceptet, fenomenet, qoftë kur flet për strukturën kulturore, (familjen, shtetin, gjininë, natyrën, trashëgiminë kulturore etj.). Ky stil i shkrimit për studentët është tejet përfitues, sepse sapo i shtie thellë në abstraksionin shkencor të fenomeneve ngadalë fillon e i nxjerr në sipërfaqe përmes shembujve e ilustrimeve konkrete, duke ua kthjelluar të gjitha.

Autori për secilën çështje dhe/ose dukuri sjell vështrime të ndryshme nga autorë të ndryshëm, duke e dhënë edhe pikëvështrimin e vet, gjë që flet për njohuri të pasura të autorit nga leximet, por edhe për përvojë të pasur empirike të tij,

duke e zhvilluar tekstin kështu në një formë konverzacioni me lexuesin. Ky konverzacion udhëzon dhe josh jo vetëm studentin, por edhe secilin lexues, që të reflektojë në mënyrë kritike, edhe për vetë autorin edhe për dukuritë, pra, të sfidojë qëndrimet e ndryshme në mënyrë tejet unike për fenomenet e diskutuara aty. Për të ilustruar të menduarit kritik mbi fenomenet e vëzhguara, si një udhëzim dhe fuqizim që të njëjtën ta bëjnë studentët në formimin e tyre profesional, do të sjell këtu një fragment ku autori shtjellon identitetet sociale. P.sh.:

Në këtë paradë të re ideologjike, vërehet një fluks i gulçimit utopik për të krijuar e imponuar si identitet gjinor secilën preferencë apo sjellje seksuale dhe/apo të bazuar në preferencë apo imagjinatë seksuale. Në fakt, avokimi transgjinor sipas vetidentifikimit apo vetëdeklarimit të gjinisë synon mohimin e neutralitetin gjinor, që nënkupton mohimin e dy gjinive kryesore, biologjike e kulturore, dhe krijimin e shumësisë transgjinore, që nënkupton sajimin e identiteteve të llojllojshme gjinore “ylberi gjinor”. Për shembull, në dekadën e

fundit kemi daljen në pah të përemrave vetorë, të cilët treguakan “gjininë kulturore” brenda *ylberit gjinor* që u konsideruakan të jenë afër 100 sosh. [...]

Pyetja vijuese që parashtrohet është psikologjike dhe kulturore: nëse ndjenja për veten qenka bazë e përkatësisë së identitetit gjinor specifik brenda *ylberit gjinor*, siç pretendojnë disa nga ideologët e transgjinisë, atëherë nëse ndërron ndjenja pas disa muajsh/vjetësh, çfarë ndodh me identitetin përkatës?...(f 185-6).

Ushtrimet që jepen në fund të çdo kapitulli dhe shtojca me udhëzimet e punës në terren janë masë shtesë, por dhe lehtësim për zhvillim dhe formim të qenësishëm profesional të studentëve, duke i angazhuar ata në ndërmarrje praktike dhe nxitje për iniciativa hulumtimi në terren, si dhe diskutime profesionale mes kolegësh, miqsh, e familjarësh, për çështje antropologjike. Në linjë me këtë shkon edhe shtojca me udhëzime për punën në terren, e cila është edhe një kontribut i rezervë i autorit që studentët të shkojnë në rrugë të drejtë e të lehtë për të dalë antropologë të suksesshëm të së nesërmes.

Bibliografia e pasur, si ndërkombëtare ashtu edhe vendore, i mundëson secilit, që ka kureshtje e interesim për njohje më të thellë e më të gjerë të çështjeve të caktuara, të shkojë tutje me lexime dhe zhvillime reflektuese në këtë fushë tejet domethënëse dhe të rëndësishme për shkencat shoqërore e humane.

Botimet universitare, por dhe tematike antropologjike në gjuhën shqipe mbesin tejet të nevojshme dhe të dëshirueshme për pasurimin e fondit të burimeve për studime në fusha humane e sociale në botën akademike shqipfolëse, andaj edhe ky botim plotëson një kërkesë bazike për studentët dhe lexuesit e tjerë të interesuar në antropologji. Një libër i tillë është tejet i nevojshëm për Departamentin e Antropologjisë dhe studentët e këtij departamenti, dhe jo vetëm, të cilëve u nevojitet qasje e lehtë dhe e përshtatshme, në gjuhën shqipe, për një pasqyrë holistike dhe të kuptueshme të kësaj fushe studimi.

**Lumnije Kadriu**